

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PULS CLINIC” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Znj. Alma Hoxhaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 16.05.1973, lindur në Gjirokastër dhe banuese në Tiranë, rruga “Migjeni”, Godina 35, H. 11, Ap. 7, Yzberisht, Kashar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 035692232;
- **Znj. Rozeta Kamberri**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 08.09.1982, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga “Siri Kodra”, Nd. 96, H. 2, Ap. 19, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 035056070;

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 28.03.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “PULS CLINIC”.
Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “PULS CLINIC”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “PULS CLINIC” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 16, H. 9, Ap. 16, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimitarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti: Qender Mjekësore. Klinikë Mjekësore me specialitete të ndryshme. Shërbime laboratorike.

Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, për përbushjen e objektit të aktivitetit të saj.

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtronjë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “PULS CLINIC” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgigjen për detyrimet e shoqërisë "PULS CLINIC" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PULS CLINIC" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zoterojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Ortaku Alma Hoxhaj, zoteron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë;
- Ortaku Rozeta Kamberi, zoteron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emëritimit është 2 vjet me të drejtë ripërtëritur. Administratorë të Shoqërisë do të jenë të dy ortakët znj. Alma Hoxhaj dhe znj. Rozeta Kamberi.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "PULS CLINIC" SHPK përgigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.


NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.


Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

ALMA HOXHAJ


Alma Hoxhaj

ROZETA KAMBERI


Rozek Kamberi
Rozek